



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.Sh. Agjensioni i Lajmeve „Kosova News“

Pronar – Naser Bujupi

OSHP TV Kosova News

Rr/Behar Begolli, Veternik p.n.

Prishtinë

Ref:1604/332/LIC/ni

Vendim

për ndërprerjen e licencës së transmetimit të OSHP TV KOSOVA NEWS, me seli në Prishtinë

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. TV KOSOVA NEWS është Ofrues i Shërbimeve Programore, i cili është licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për transmetimin e TV programeve përmes sistemit të Operatorëve Kabllorë , me seli në Prishtinë. KPM, me datën 30 dhjetor 2009, ka marr vendim për dhënien e licencës për TV KOSOVA NEWS.
3. Më datën 14 mars 2016, pronari i OSHP TV KOSOVA NEWS, përmes një shkrese tw dorzuar nw KPM, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e transmetimit të OSHP TV KOSOVA NEWS.

Arsyetimi

4. Në bazë të njoftimit zyrtar nga ana e pronarit të OSHP TV KOSOVA NEWS, për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së, Zyra Ekzekutive konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së OSHP TV KOSOVA NEWS.

1/2

Vendim

5. Komisioni, në takimin e mbajtur me datën 21 prill 2016, merr vendim për ndërprerjen e licencës së OSHP TV KOSOVA NEWS, ndërsa, procedurat për shlyerjen e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, mbetet të zbatohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi.


Lëshimi i Vendimit

6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit të tij.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



21.04.2016

datë